

DOKUMENTACIONI I APLIKANTËVE PËR TRANSFERIM STUDIMESH PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI

A- Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh paraqesin në Drejtorinë e Kurrikulave dokumentacionin e mëposhtëm: (Kreu III, pika 6 i Udhëzimit të MAS nr.12, datë 30.06.2023)

- a- Kërkesën drejtuar IAL për programin e studimit në të cilin do të transferojnë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.3).
- b- Deklaratën sipas shtojcës nr.1 të Udhëzimit të MAS nr.12, datë 30.06.2023
- c- Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse.
- d- Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.

Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet ti dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe.

- e- Kopje e njehsuar me origjinalin të diplomës së maturës shtetërore/ dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011.
- f- Fotokopje dokumentit të identifikimit.
- g- Dy fotografi personale.
- h- Kopje e mandate pagesës.

B- Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi paraqesin në Drejtorinë e Kurrikulave dokumentacionin e mëposhtëm:

- a- Kërkesën drejtuar IAL për programin e studimit në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.3).
- b- Kopje e njehsuar me origjinalin të diplomës dhe listën e notave, suplementin e diplomës studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë.
- c- Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.
- d- Kopje e njehsuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme.
- e- Kopje e dokumentit të identifikimit dokumentit të identifikimit.

f- Dy fotografi personale.

g- Kopje e mandate pagesës.

C- Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidateve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidateve të komunitetit rom dhe egjiptian në programet e ciklit të parë të studimeve paraqesin në Drejtorinë e Kurrikulave dokumentacionin e mëposhtëm: (Kreu V, pika 8 i Udhëzimit të MAS nr.13, datë 30.06.2023)

a- Kërkesën drejtuar IAL për programin e studimit në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.2).

b- Deklaratën sipas shtojcës nr.1 pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c- Kopje e dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është e njohur shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

d- Kopje e njehsuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe (nëse është lëshuar në gjuhë të huaj) të diplomës së maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave të fituara në vendin përkatës të legalizuar nga autoritetet vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet.

e- Kopje dokumentit të identifikimit.

f- Dy fotografi personale.

g- Kopje e mandate pagesës.

Dokumentacioni dorezohet ne Drejtorine e kurrikulave nga data 02-13 shtator 2024